

Njoftim i përqendrimit me të cilin Saudi Aramko Development Kompani, Dahran dhe Eksel Investments Holandia B.V. Holandë do të formojnë një sipërmarrje të përbashkët plotësisht funksionale (lënda nr. 08-74/2023)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 12.05.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet një sipërmarrjeje të përbashkët plotësisht funksionale nga **Saudi Aramko Development Kompani**(Saudi Aramco Development Company), me seli të regjistruar në kutinë postare 5000, Dahran, 31311, Mbretëria e Arabisë Saudite, dhe **Eksel Investments Holandia B.V.**(Exel Investments Netherlands B.V.), me seli të regjistruar në P. De Kubertinveg 7 N6225XT, Maastricht, Holandë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

Saudi Aramko Development Kompani është shoqëri e varur në pronësi të plotë të Saudi Arabian Oil Kampani (Saudi Arabian Oil Company; „Saudi Aramko“). Saudi Aramko është i angazhuar kryesisht me kërkime gjeologjike, shpimin dhe nxjerrjen e substancave të hidrokarbureve dhe përpunimin, prodhimin, rafinimin dhe marketingun e këtyre substancave.

Saudi Aramko nuk është e regjistruar në Maqedoninë e Veriut.

Eksel Investments Holandia B.V.(Exel Investments Netherlands B.V.), është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila nuk është e listuar në bursë, e themeluar sipas ligjeve të Holandës dhe është një shoqëri e varur në pronësi të plotë indirekte të Dojçe Post AG (Deutsche Post AG).

Dojçe Post AG është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërisë së saj të varur të DHL EKSPRESS MACEDONIA SHPKNJP Shkup, me seli në rr. 32 nr. 5 Ilinden, me aktivitet kryesor të regjistruar - Veprimtari për ofrimin e shërbimeve të tjera postare dhe të korrierit. Shërbimet e ofruara në Maqedoninë e Veriut përfshijnë menaxhimin e dërgesave, si dhe shërbimet postare dhe të korrierit.

Sipërmarrja e përbashkët do të themelohet në Arabinë Saudite dhe do të jetë aktive në zhvillimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e objekteve për të ofruar shërbime të prokurimit dhe logjistikës në Arabinë Saudite dhe në rajonin e Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut. Aktualisht, nuk është paraparë që Sipërmarrja e përbashkët nuk pritet të ofrojë shërbimet e veta në Maqedoninë e Veriut.

Sipas parashtruesve, tregu relevant i mallrave për përqendrimin e parashtruar mund të përkufizohet si një treg i shërbimeve logjistike me porosi.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

16.05. 2023

Shkup

